



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-040/2

Prishtinë, më 23 tetor 2015, në orën 22:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 TETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi dhe Xheladin Hoxha.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Krijimi i kushteve për mbarëvajtjen e seancës plenare

Kryetari i njoftoi të pranishmit lidhur me situatën e krijuar në Kuvend për shkak të bllokadës që po i bëjnë deputetët e grupeve parlamentare të opozitës.

Ai propozoi që Kryesia e Kuvendit duhet të marrë vendim që të krijohen kushte normale për punën e Kuvendit.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me këtë çështje.

Lidhur me zhblokimin e punës së Kuvendit diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli; nënkryetarët e Kuvendit Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Duda Balje, si dhe kryetarët e grupeve parlamentare, Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Myfera Shinik, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, në mbështetje të nenit 67.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të nenit 41, paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit, e në pamundësi për mbajtjen e seancave plenare, më 17 shtator, 8, 15 e 23 tetor, kur është bllokuar puna e seancës plenare, është cenuar siguria dhe shëndeti i deputetëve, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2015, me shumicë votash (katër për dhe një kundër), mori këtë:

Vendim

Kërkohet veprim plotësues, duke përfshirë ndërhyrjen e zyrtareve të Policisë për siguri, për mbrojtjen e shëndeti të deputetëve dhe për mbarëvajtjen e punimeve të seancës plenare.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 23:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale